Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterive Tirane
Nr 8623 Rep.
Nr 815 Kol.

AKT THEMELIMI

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE

"GJOKA KONSTRUKSION"SHA

Nënshkruar në Tiranë, sot në datën, 03.09.2008

Sot në datën 03.09.2008, perpara meje Noteres Halil Sinani, Notere e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqit personalisht Z. Rrok Gjoka, person me shtetesi shqiptare, lindur ne Puke, i datelindjes 4 Janar 1951, me adrese banimi Rruga "Elbasanit", Vilat Sauk, Tirane, Mbajtes i Pasaportes me Nr. S 0001159, i cili me deklaroi se ai ne cilesine e Aksionarit te vetem vendosi qe te krijohet shoqëria aksionare "GJOKA KONSTRUKSION" Sh.A sipas kushteve të mëposhtme:

NENI 1

Emertimi i shoqerise aksionare me oferte private eshte "GJOKA KONSTRUKSION" SHA.

NENI 2

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e vet në territorin e Shqipërisë.
Shoqëria gjithashtu mund të hapë degë në territorin e Shqipërisë ose përfaqësi të saj jashtë këtij territori, me vendim të organeve drejtuese kompetente te caktuara nga ligji.

Selia e Shoqërisë do të jetë në Adresen: rruga "Dora D'istria" N.1, Tirane, Shqiperi.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë është vendosur të jetë pa afat të caktuar.

NENI 4

Shoqëria "GJOKA KONSTRUKSION" do te ketë si objekt te saj:

Projektimi dhe ndertimet te karaktereve te llojeve te ndryshme sipas licensave te ndryshme me te cilat shoqeri eshte pajisur dhe do te pajiset ne te ardhmen, prodhimi i materialeve te ndertimit, inerteve, betonit te markave te ndryshme, te parafabrikateve te betonit, prodhimit te asfaltit etj.

Importimin dhe/ose eksportimin e karburanteve, te lendeve djegese per perdorim familjar ose industrial, te vajrave dhe/ose lendeve lubrifikuese etj

Ngritjen dhe funksionimin e stacioneve te shitjes se karburanteve, gazit te lengshem dhe vajrave lubrifikante;